



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



UNITED NATIONS  
ALBANIA



# ARSIMI



## GJITHËPËRFSHIRËS \*



### NË SHKOLLAT

## QENDËR KOMUNITARE

2023

Prill

[www.ascap.edu.al](http://www.ascap.edu.al)



# PËRMBAJTJA

I. KONCEPTI “SHKOLLA QENDËR KOMUNITARE” .....	2
Përfitimet e shkollës si qendër komunitare .....	3
II. ZBATIMI I STANDARDEVE TË SHQK-SË .....	5
Çfarë janë standardet e SHQK-së .....	5
Standardet e ShQK-së janë një përmbledhje e karakteristikave më themelore që duhet të ketë një shkollë për të përmbushur misionin e saj komunitar. ....	5
1. Fusha: Sigurimi i arsimit cilësor për çdo nxënës .....	5
2. Fusha: Sigurimi i mirëqenies sociale, emocionale, shëndetësore të nxënësve .....	5
3. Fusha: Angazhimi dhe zhvillimi i komunitetit .....	6
4. Fusha: Vendimmarrja e përbashkët .....	6
5. Fusha: Gjithëpërfshirja dhe respektimi i diversitetit .....	7
III. GJITHPËRFSHIRJA DHE RESPEKTIMI I DIVERSITETIT NË SHKOLLAT SHQK .....	12
Sqarimi konceptit .....	12
Njohja e lëvizjes ndërkombëtare drejt përfshirjes dhe legjislacioni shqiptar .....	15
GJITHPËRFSHIRJA DHE RESPEKTIMI I DIVERSITETIT NË NIVEL SHKOLLE .....	20
Përfitimet prej gjithëpërfshirjes .....	22
Planifikimi i gjithëpërfshirjes në nivel shkolle .....	23
Hartimi i politikave shkollore gjithëpërfshirëse .....	26
Politika e regjistrimit në shkolla .....	29
Frekuentimi dhe pjesëmarrja .....	30
INSTRUMENT VETËVLERËSIMI .....	33
Fusha V - Gjithëpërfshirja dhe respektimi i diversitetit .....	33

## I. KONCEPTI “SHKOLLA QENDËR KOMUNITARE”

***Shkolla Qendër Komunitare (ShQK) është një model promovues dhe zhvillues për ta kthyer shkollën në vendin ku ndërtohet partneriteti shkollë-familje-komunitet dhe bashkëpunohet për zhvillimin e potencialit të plotë të çdo nxënësi.***

Legjislacioni aktual për arsimin mbështet funksionimin e një shkolle të hapur për vendimmarrje të përbashkët me familjen dhe komunitetin.

Koncepti i shkollës qendër komunitare mbështetet në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve dhe paraqet një qasje gjithëpërfshirëse, që ndërlidh të gjitha aspektet e reformës në arsim.

Shkolla qendër komunitare synon zhvillimin cilësor të shkollës dhe përgatitjen e fëmijëve dhe të rinjve si qytetarë të gatshëm dhe të aftë për të kontribuar në komunitetet e tyre.

Qasja e SHQK është një dimension i rëndësishëm i reformimit të arsimit dhe përmirësimit të cilësisë së tij. Ajo krijon mundësinë e vlerësimit të punës së shkollës në lidhje me komponentët e shkollës komunitare - miqësore për fëmijët dhe të rinjtë, dhe mbi këtë bazë hartimin e strategjive që mbështesin ngritjen e një modeli të shkollës miqësore për të gjithë, përmes bashkëpunimit të të gjithë aktorëve.

Shkolla qendër komunitare dallon për fokusin e saj në zhvillimin akademik të fëmijëve dhe të rinjve, angazhimin dhe kontributin qytetar, mbështetjen e familjes, shërbimet sociale me fokus në mbrojtjen dhe shëndetin si dhe shërbimet komunitare. SHQK është një bashkëpunim mes aktorëve në komunitet, prindërve dhe shkollës, i fokusuar në mbështetjen e zhvillimit të fëmijëve dhe të rinjve, përmirësimin e arritjeve të tyre, mbështetjen e familjeve dhe zhvillimin e komuniteteve të konsoliduara.

SHQK synon zhvillimin cilësor të shkollës dhe aftësimin e fëmijëve dhe të rinjve si qytetarë të gatshëm dhe të aftë për të kontribuar në komunitetet e tyre. Sistemi arsimor shqiptar ka nevojë për shkollat komunitare sepse kërkimi dhe përvoja ka treguar që fëmijët dhe të

rinjtë kanë nevojë për shumë mundësi dhe mbështetje që të kenë sukses. SHQK njih fuqinë e të punuarit së bashku për një qëllim të përbashkët.

- ✓ SHQK bëhen ato institucione arsimore – qendra të komunitetit, të cilat janë të hapura për këdo dhe në çdo kohë. Ato janë të disponueshme për të gjithë anëtarët e komunitetit çdo ditë të javës.
- ✓ SHQK-të janë institucione të cilat e ngrenë dhe e zhvillojnë punën e tyre bazuar në nevojat e nxënësve, të familjeve dhe komunitetit të gjerë.
- ✓ Shkollat qendra komunitare ofrojnë një sërë shërbimesh, pas orarit mësimor, në shtatë ditët e javës, për nxënësit, familjet dhe komunitetin.
- ✓ Në shkollat qendra komunitare mësuesit dhe nxënësit i konsiderojnë prindërit si bashkëedukatorë dhe i angazhojnë ata në vendimmarrje të përbashkëta për çështje që lidhen me edukimin cilësor sipas fushave të standardeve të ShQK-së.
- ✓ Shkollat qendra komunitare sigurojnë kohezionin social (forca që i mban të bashkuara fort të gjitha palët dhe shtresat brenda komunitetit).
- ✓ Shkollat qendra komunitare ngrihen mbi pikat e forta të komunitetit duke u bazuar në hartëzimin e burimeve njerëzore, sociale, materiale, natyrore, shpirtërore dhe financiare që ekzistojnë në një komunitet.

### **Përfitimet e shkollës si qendër komunitare**

Shkolla qendër komunitare:

- Është miqësore dhe e dashur për fëmijët dhe të rinjtë.
- Pasuron dhe rrit të nxënësve përmes veprimtarive formale dhe joformale.
- Ndërton strategji të qëndrueshme për fëmijët, të rinjtë dhe familjet.
- Siguron një infrastrukturë që ofron dhe integron shërbime komunitare.
- Rrit përdorimin e shërbimeve që mund të ofrojnë një institucion arsimor në një zonë të caktuar.
- Integron dhe koordinon shërbimet ekzistuese publike.
- Maksimizon dhe përmirëson komunikimin mes shkollës dhe komunitetit.

- Përforcon (fuqizon) ndjenjën e komunitetit dhe përmirëson cilësinë e jetës në lokalitetin e shkollës.
- Siguron mundësi më të mëdha për banorët të përfshihen në veprimtaritë e komunitetit.
- Siguron mundësi që banorët në komunitet, prindërit, mësuesit dhe nxënësit të adresojnë nevoja të vecanta të komunitetit të tyre.
- Zhvillon mënyra të reja të përmirësimit të mirëqenies ekonomike të komunitetit.
- Sjell në shkollë burime shtesë.

**Parimet bazë që udhëheqin Shkollën Qendër Komunitare janë:**

- Sigurimi i një arsimit cilësor për të gjithë nxënësit.
- Sigurimi i mirëqenies sociale, emocionale, shëndetësore të nxënësve.
- Angazhimi dhe zhvillimi i komunitetit.
- Vendimmarrja e përbashkët.
- Respektimi i diversitetit.
- Përdorimi i burimeve komunitare në shërbim të shkollës.

## II. ZBATIMI I STANDARDEVE TË SHQK-SË

Çfarë janë standardet e SHQK-së

***Standardet e ShQK-së janë një përmbledhje e karakteristikave më themelore që duhet të ketë një shkollë për të përmbushur misionin e saj komunitar.***

Ato janë të shprehura nëpërmjet pesë fushave dhe për secilën fushë jepen standardet dhe treguesit përkatës, të cilët janë të matshëm.

**Fushat e standardeve janë:**

1. Sigurimi i arsimit cilësor për çdo nxënës
2. Sigurimi i mirëqenies sociale, emocionale, shëndetësore të nxënësve
3. Angazhimi dhe zhvillimi i komunitetit
4. Vendimmarrja e përbashkët
5. Gjithëpërfshirja dhe respektimi i diversitetit

### ***1. Fusha: Sigurimi i arsimit cilësor për çdo nxënës***

Shkolla si qendër komunitare ofron programe dhe shërbime që sigurojnë mbështetje dhe zhvillim akademik për nxënësit dhe të rinjtë, duke plotësuar programin mësimor. Shkolla ndërton programe akademike (si kurset/klasat e shkencës, kurse plotësuese për nxënësit me vështirësi etj.), programe të zhvillimit kulturor (si, kurset/klasat e artit, të vallëzimit, muzikës, historisë etj.) të cilat nuk i mbivendosen programeve dhe përvojave të nxënësit në orën e mësimin.

### ***2. Fusha: Sigurimi i mirëqenies sociale, emocionale, shëndetësore të nxënësve***

Shkolla qendër komunitare mundëson që programet dhe shërbimet që ajo ofron t'i adresohen nevojave të zhvillimit fizik, mendor, emocional dhe social të nxënësve, familjeve dhe komunitetit. Nxënësit, prindërit dhe anëtarë të tjerë të komunitetit gjejnë në shkollë informacionin dhe mjetet për përmbushjen e këtyre nevojave. Shkolla ndërton programe të

zhvillimit për mirëqenien dhe shëndetin (si, kurset/klasat/ekipet sportive për lojëra të ndryshme si volejball, basketboll, futboll, aerobi, etj., programe për prindërit – shfrytëzim i terreneve sportive, etj).

### ***3. Fusha: Angazhimi dhe zhvillimi i komunitetit***

Shkolla si qendër komunitare bashkëpunon ngushtë me komunitetin dhe mundëson programe, shërbime dhe mbështetje për anëtarët e komunitetit. Kjo shërben si burim për të nxënit e komunitetit dhe shfrytëzimin e burimeve të komunitetit për zhvillimin e fëmijëve, të rinjve dhe familjeve. Shkolla ndërton programe, si planifikimi dhe zbatimi i projekteve të përbashkëta me shkollën dhe organizma lokale, angazhim i komunitetit në përmbushjen cilësisht të kurrikulës, p.sh., shërbimi komunitar në gjimnaz, projektet kurrikulare, modulet profesionale, veprimtaritë edukative etj. Shkolla si qendër komunitare i konsideron prindërit si partnerë dhe burime të rëndësishëm. Ajo krijon një klimë pozitive, mirëseardhje dhe bashkëpunimi, si dhe ndërton programe për përfshirjen e prindërve. Këto mund të jenë programe që plotësojnë nevojat e prindërve, programe që i ndihmojnë prindërit të mbështesin fëmijët e tyre si dhe mundësojnë angazhimin e tyre në ndihmë të shkollës (si, pjesëmarrja në vendimmarrje dhe në planifikimin e veprimtarive në shkollë, programe për të nxënit e të rriturve – kurse/klasa kompjuteri, kurse/klasa për zhvillimin e aftësive të thjeshta profesionale, programe për ndihmën që mund të japin prindërit për nxënësit që kanë vështirësi, etj.).

### ***4. Fusha: Vendimmarrja e përbashkët***

Prindërit, komuniteti dhe stafi i shkollës janë partnerë të rëndësishëm dhe të barabartë në vendimmarrjet që ndikojnë në cilësinë e shkollës dhe arritjet e nxënësve. Ata së bashku mund të informojnë, ndikojnë dhe krijojnë politika, praktika dhe programe në dobi të suksesit të nxënësve. Funksionimi i Bordit të shkollës dhe Këshillave të prindërve krijon një mentalitet të ri për pozicionin dhe rolin e prindërve në shkollë, duke i parë ata si partnerë dhe pjesëmarrës aktivë në proceset e vendimmarrjes në shkollë dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme.

## **5. Fusha: Gjithëpërfshirja dhe respektimi i diversitetit**

Shkolla u siguron të gjithë fëmijëve të drejtën themelorë për arsim dhe mundësi të barabarta pa dallim të origjinës, identitetit kulturor, gjuhës, aftësive, apo rrethanave ekonomike, respektim të vlerave të shoqërisë, të bashkëjetesës në shoqëri, si dhe të qenit qytetar aktiv në botën e ndërvarur.

### **Vetëvlerësimi i standardeve të shkollës qendër komunitare**

Përdoruesi i parë dhe më kryesor i standardeve është shkolla. Standardet i vijnë në ndihmë shkollës:

- ✓ Të ndërmarrë veprimtari për identifikimin e nevojave dhe përcaktimin e prioriteteve, për të mbështetur të nxënit e nxënësve dhe përmirësuar arritjet e tyre.
- ✓ Të identifikojë pikat e forta dhe të dobëta, të cilat sigurojnë informacionin e nevojshëm për planifikimet strategjike.
- ✓ Të përcaktojë fokusin e punës me partnerët dhe aktorët e tjerë.
- ✓ Të sigurojë feedback të vazhdueshëm nga nxënësit dhe familjet për të ndërtuar marrëdhënie të fuqishme me ta.
- ✓ Të vlerësojë dhe rishikojë cilësinë e marrëdhënieve me komunitetin.

Në procesin e shndërrimit të saj në qendër komunitare, çdo shkollë synon të shkojë drejt përmbushjes së standardeve të SHQK. Në rrugën për të përmbushur këto standarde, çdo shkollë ndjek itinerarin e saj, bazuar në nevojat, kushtet dhe mundësitë konkrete të saj dhe të komunitetit që e rrethon.

Shkolla, duke u mbështetur te standardet, mund të bëjë vetë një vlerësim të punës së saj, për të konfirmuar nivelin ku ndodhet dhe përmirësimet që duhet të bëjë. Të dhënat që shkolla mbledh përmes procesit të vlerësimit orientojnë procesin e planifikimit të veprimtarive të shkollës si qendër komunitare, si dhe përcaktojnë llojin e veprimtarive dhe të shërbimeve që shkolla mund të ofrojë. Këto vlerësime shërbejnë si një “baseline” që



shkolla mund ta përdorë për qëllime të shumta. Në këtë mënyrë çdo vlerësim i ri që mund të bëhet më tej si dhe të dhënat që rezultojnë prej tij mundësojnë krahasimin me “baseline- in” që shkolla do të vendosë fillimisht.

### **Realizimi i procesit të vlerësimit të standardeve**

Në procesin e vlerësimit të standardeve të shkollës si qendër komunitare, është shumë e rëndësishme që të gjithë aktorët të marrin pjesë dhe, më pas, në hartimin e planit të punës, që do t’i përgjigjej më mirë arritjes së disa prej treguesve të standardeve të ShQK-së

Mësuesit koordinatorë ndihmojnë në vlerësimin e standardeve të ShQK-së, duke marrë në konsideratë mendimet dhe pikëzimin e nxënësve, prindërve dhe anëtarëve të bordit. Pas realizimit të vlerësimit të standardeve, këta aktorë hartojnë bashkërisht planin e punës së ShQK-së.

Qasja e sugjeruar është që treguesit të vlerësohen fillimisht nga të tria grupet veçmas. Brenda një dite mund të ndodhë procesi i vlerësimit, ku fëmijët, prindërit dhe mësuesit vlerësojnë treguesit në grupe të veçanta. Ky proces është shumë i rëndësishëm për faktin që krijon hapësirën e duhur që fëmijët me ndihmën e lehtësuesit të vlerësojnë të gjithë treguesit sipas mendimit të tyre, e njëjta gjë për prindërit dhe më pas për mësuesit. Pas kësaj pjese të procesit, roli i mësuesit koordinator si lehtësues i takimit është shumë i rëndësishëm për të sjellë bashkë përfaqësi nga tri grupet, ku të diskutohet pikëzimi i përbashkët.

Një nga metodologjitë e sugjeruara për vlerësimin në grup është që të gjithë pjesëmarrësit që janë në grupe të caktuara, në të njëjtën kohë, vlerësojnë në shkallën 1-10, vlerën që ata mendojnë se përfaqëson realitetin në shkollën e tyre. Kjo metodologji i jep çdo pjesëtar të një grupi më shumë mundësi për të shprehur mendimin e vet pa u influencuar nga të tjerët. Më pas diskutohen pikët dhe bihet dakord me grupin. Ndërkohë, për vlerësimin në një grup të madh (me përfaqësinë nga të tria grupet), dy nga metodat e testuara kanë qenë si vijon:

**Skenari 1:** Mësuesi koordinator përmbledh vlerësimin e tria grupeve për secilin nga treguesit, në mënyrë transparente, dhe më pas nxjerr mesataren, duke i vendosur treguesit në fjalë mesataren e pikëve të të tria grupeve.

**Skenari 2:** Skenari i dytë që ka funksionuar në lidhje me rënien dakord të grupeve, ka qenë metodologjia ku të tria grupet me anë të përfaqësuesve negociojnë mes tyre nën lehtësimin e koordinatorit shkollor për çdo tregues. Kjo ka rezultuar si qasja më e gjatë, por më efektive, pasi diskutimi i gjeneruar mes grupeve ndihmon për të arritur të kuptuarin akoma më të mirë të standardeve dhe përmbajtjes së tyre. E rëndësishme është që para çdo vlerësimi, mësuesi koordinator të shpjegojë kuptimin e fushave, standardeve dhe treguesve.

Ky proces është mjaft i rëndësishëm për faktin që personat e përfshirë në vlerësim do të jenë në gjendje të zhvillojnë një proces më të qëllimshëm analize të situatës së shkollës. Procesi që shkolla kalon duke u ndalur te çdo tregues, ka treguar që shkollat që kanë ndjekur këtë lloj procesi edhe planet e ShQK-së i kanë më strategjike dhe të bazuara realisht mbi fushat dhe treguesit që duhen përmirësuar.

### **Zhvillimi i veprimtarive të SHQK-së**

Çdo shkollë, pasi ka kryer një vlerësim të treguesve të standardeve sipas fushave, mund të zhvillojë planin e vet të veprimtarive i cili nuk mund të ngjajë me atë të një shkolle tjetër për arsye të specifikave që ka secila shkollë. Veprimtaritë që ofrohen në planin e shkollës duhet të jenë me interes për të gjithë aktorët dhe të sigurojnë pjesëmarrjen dhe përfshirjen e vazhdueshme të tyre.

Planet e veprimtarive të shkollës qendër komunitare mund të përfshijnë ndër llojet e mëposhtme të veprimtarive.

#### *a. Veprimtari për zhvillimin akademik të nxënësve*

Shkolla si qendër komunitare ofron programe dhe shërbime që sigurojnë mbështetje dhe zhvillim akademik për nxënësit dhe të rinjtë, duke plotësuar programin mësimor.

Ka disa rrugë për të mbështetur zhvillimin akademik të nxënësve:

- Veprimtari për përforcim të të nxënit. Këto veprimtari bëhen për të zotëruar më mirë aftësitë që nxënësi po mëson në klasën e tij siç janë konsultimet lidhur me lëndët.
- Veprimtari për pasurimin e zhvillimit akademik. Këto kurse/klube ngrihen mbi përmbajtjen e lëndës që nxënësi po zhvillon në klasën e tij dhe thellojnë dijet në një fushë të caktuar kurrikulare apo dhe fushave të tjera kurrikulare.

Shkolla ndërton kurse akademike (si kurset e shkencës, kurse plotësuese për nxënësit me vështirësi, etj.), të cilat nuk i mbivendosen programeve dhe përvojave të nxënësit në orën e mësimit.

Shkolla ngre klube në mbështetje të thellimit dhe plotësimit të njohurive të tij në fusha të ndryshme apo të zhvillimit të të menduarit kritik (si klubet e debatit, klubet e leximit, klubet fjalës poetike etj).

*b. Veprimtari për zhvillimin artistik, kulturor dhe sportiv*

Shkolla si qendër komunitare mundëson që programet dhe shërbimet që ajo ofron t'i adresohen nevojave të zhvillimit fizik, mendor, emocional dhe social të nxënësve. Nxënësit gjejnë në shkollë informacionin dhe mjetet për përmbushjen e këtyre nevojave.

Veprimtari që nxisin këtë aspekt të zhvillimit të nxënësve janë:

- Veprimtaritë sportive si volejball, basketboll, futboll, aerobi, etj
- Veprimtari kulturore si teatër, muzikë, kërcim, dramë, recitim, stilim, pikturë, etj

*c. Veprimtari për angazhimin dhe mbështetjen e familjes*

Shkolla si qendër komunitare i konsideron prindërit si partnerë dhe burim të rëndësishëm. Ajo krijon një klimë pozitive, mirëseardhje dhe bashkëpunimi, si dhe ndërton programe për përfshirjen e prindërve.

Këto mund të jenë veprimtari që:

- ndihmojnë prindërit të ndjekin përparimin e fëmijës. Shkolla është tërësisht transparente para prindërve. Të tilla veprimtari janë, fletët informuese për prindërit, ditari i nxënësit, takimet periodike me mësuesit, etj
- ndihmojnë prindërit të mbështesin fëmijët e tyre dhe shkollën si institucion, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit në shkollë. Të tilla veprimtari janë përfshirja në vendimmarrje përmes marrjes pjesë në organizma të shkollës (bordi i shkollës, këshilli i prindërve, etj), pjesëmarrjes në planifikimin e veprimtarive në shkollë (plani afatmesëm dhe vjetor i shkollës, projekte të shkollës, etj), pjesëmarrja në programe për të nxënin e nxënësve apo të rriturve (kurse kompjuteri, kurse për zhvillimin e aftësive të thjeshta profesionale, programe për ndihmën që mund të japin prindërit për nxënësit që kanë vështirësi, etj).
- plotësojnë nevojat e prindërve. Këtu përfshihen veprimtari ku prindërit shfrytëzojnë burimet që ofron shkolla (biblioteka, kompjuterët dhe interneti, mjediset dhe pajisjet sportive, etj.) si dhe veprimtari ku prindërve shkolla i ofron ekspertizën e saj për të plotësuar një nevojë në një fushë të caktuar (kurse kompjuteri, gjuhë të huaj etj.)

*d. Veprimtari për angazhimin e komunitetit*

Shkolla si qendër komunitare bashkëpunon ngushtë me komunitetin dhe mundëson programe, shërbime dhe mbështetje për anëtarët e komunitetit. Kjo shërben si burim për të nxënit e komunitetit dhe shfrytëzimin e burimeve të komunitetit për zhvillimin e fëmijëve, të rinjve dhe familjeve.

Shkolla përdor rrugë të ndryshme për të bashkëpunuar me komunitetin. Këto mund të jenë veprimtari:

- për të sjellë shërbimet dhe programet e komunitetit në shkollë. Në këtë rast shkolla vlerëson dhe shfrytëzon asetet e komunitetit si organizata dhe

institucione, qendra të shëndetit fizik e mendor, institucione të arit dhe kulturës, biznese, etj.

- që fokusohen në projekte të përbashkëta që ndihmojnë shkollën dhe shërbimin komunitar.
- për të plotësuar nevojat e komunitetit. Këtu përfshihen veprimtari ku si prindërit, pjesëtarë të tjerë të komunitetit shfrytëzojnë burimet që ofron shkolla.

### III. GJITHPËRFSHIRJA DHE RESPEKTIMI I DIVERSITETIT NË SHKOLLAT SHQK

#### Sqarimi konceptit

Gjithëpërfshirja në edukim, dikur është menduar si qasje e nevojshme, vetëm për arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta. Edhe pse secili prej nesh mund të ketë formuar një perceptim të pjesshëm, apo progresiv ndaj kuptimit të këtij procesi, shtimi i informacionit përmes leximit, apo marrjes pjesë në mënyrë direkte në këtë proces, do të na ndihmojë të kuptojmë se: *Gjithëpërfshirja është i gjithë procesi që sigurojnë mësuesit për përfshirjen e gjithë nxënësve të klasës apo shkollës, në veprimtarinë edukative dhe mësimore. Në këtë mënyrë, edhe fëmijët me nevoja të veçanta kalojnë pjesën më të madhe të kohës me fëmijët e tjerë.*

*Edukimi gjithëpërfshirës dallon tejet nga nocioni “integrim”, i cili në thelb, përqendrohet vetëm te paaftësia, apo nevojat specifike të fëmijëve, duke synuar përshtatjen e këtyre fëmijëve me paaftësi apo nevoja të veçanta në një mjedis prej të cilit mund të ndryshojnë disi, apo thjesht të jenë në një mjedis me të tjerë, për të dalë nga guacka e problemit që mbartin.*

*Gjithëpërfshirja nënkupton pjesëmarrje, nënkupton të mësosh së bashku me të tjerët duke bashkëpunuar me bashkëmoshatarët e duke ndarë të njëjtat përvoja të të nxënit. Në këtë mënyrë, ky process ndihmon të gjithë fëmijët të njohin, pranojnë e vlerësojnë veten.*

*Gjithëpërfshirja është e drejta e çdo fëmije për të marrë pjesë dhe detyrimi i shkollës për të pranuar çdo fëmijë e për t'i dhënë atij aftësinë për të përdorur gjithë potencialin që mbart brenda vetes.*

Dinamika e zhvillimit të shoqërisë shqiptare në ditë e sotme, na qas me stile jetese nga më të ndryshmet, të cilat shërbejnë si sfonde prej të cilave vijnë fëmijët në shkollat tona. E kur themi gjithëpërfshirje, nuk duhet ta kuptojmë këtë qasje si të tillë vetëm për fëmijët me nevoja të veçanta lehtësisht të dukshme, por, duhet të jemi vigjilentë për çdo nevojë të veçantë emocionale që mund të paraqesë një fëmijë i cili vuan mosmarrëveshjet verbale të prindërve në shtëpi, një fëmijë i cili nuk motivohet të përparojë pasi, nuk ka mundësinë ekonomike të hajë shëndetshëm, apo të gjejë informacione shtesë në lëndë të caktuara, një fëmijë i cili sapo është kthyer nga emigrimi dhe po përjeton “shock-un kulturor”, përveç vështirësive të gjuhës, i cili ndikon në arritjet më të mira të mundshme për të, një fëmijë i cili jeton vetëm me gjyshërit, pasi, prindërit i ka në emigrim dhe ka vështirësi në përcaktimin e qartë të figurave prindërore e sa e sa stile të ndryshme jetese, një fëmijë i cili vjen nga një komunitet apo pakicë kombëtare ose kulturore, me një sfond kulturor tejet të ndryshëm nga ai i shumicës që paraqesin fëmijët në shkollat tona.

Gjithëpërfshirja është qasje për të gjithë fëmijët, të cilët në një çast të caktuar të jetës së tyre, apo, për një periudhë të konsiderueshme kohore, mund të shfaqin një nevojë të veçantë fizike, emocionale, sociale, ekonomike.

Shkollë gjithëpërfshirëse, do të thotë një institucion edukimi nga fillojnë vlerat nga humanizmi dhe rriten drejt atyre më të larta kombëtare dhe universale - një institucion që të udhëhiqet prej:

VIZIONIT

Një model edukimi ku të gjithë fëmijët arrijnë potencialin e tyre të të nxënës dhe në të cilin vendimet bazohen te nevojat individuale të nxënësve.

## NJOHJES

Edukimi gjithëpërfshirës është një filozofi dhe praktikë pedagogjike, e cila lejon çdo nxënës, të ndjehet i respektuar, i sigurt, i mbrojtur deri në atë masë, sa të zhvillojë plotësisht potencialin e vet. Është i bazuar në një sistem vlerash dhe besimesh të përqendruara në interesin më të lartë të nxënësit, prej të cilit përftohet përkatësi, pjesëmarrje aktive, përvojë e plotë shkollore dhe ndërveprime pozitive me bashkëmoshatarët dhe të tjerët në komunitet.

## PARIMEVE

- Të gjithë nxënësit respektohen si individë. Gjatë gjithë kohës punohet për të njohur pikat e tyre të forta, aftësitë dhe nevojat e ndryshme në të nxënës, të cilat përbëjnë themelin për të identifikuar, kuptuar dhe përshtatur marrëdhënien.
- Të gjithë nxënësit kanë të drejtën të mësojnë në një mjedis pozitiv të nxënës.
- Vlerësimi i arritjeve të çdo nxënësi është i ndryshëm, unik, i përshtatshëm, i papërsëritshëm, i mjaftueshëm për të ndërtuar më tej mësimdhënien.
- Aftësitë, qëndrimet dhe njohuritë e nevojshme për një të nxënës të suksesshëm të të gjithë nxënësve, janë detyrim i gjithë personelit që punon me nxënësit, përmes zhvillimit të vazhdueshëm profesional dhe arritjes së standardeve profesionale.
- Partneriteti i shkollës me familjen, komunitetin, perceptohet si investim në marrëdhënien me fëmijët.

## PËRSHTATJES

Përshtatja nënkupton ndryshimin e kushteve të të nxënës për të plotësuar nevojat e nxënësve,

më tepër se sa përpjekje e nxënësve për t'iu përshtatur nevojave të sistemit.

## TRANSPARENCËS

Praktikat e gjithëpërfshirjes në shkollë janë sinonim i praktikave të suksesshme po në shkollë. Për këtë arsye, duhet të përcaktohen qartë tregues për të matur këto praktika të suksesshme e gjithëpërfshirëse si rrjedhojë, të cilët mund të përdoren për përmirësimin e mëtejshëm të procesit e rezultatet e të cilave t'u bëhen të njohura të gjithë partnerëve të shkollës, në mënyrë parësore familjes.

### **Njohja e lëvizjes ndërkombëtare drejt përfshirjes dhe legjislacioni shqiptar**

Praktika e përfshirjes së nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme, është shtrirë tashmë tejte në mënyrë ndërkombëtare. Tri prej ilustrimeve të lëvizjes drejt përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin e përgjithshëm, po i paraqesim më poshtë:

#### **1. DEKLARATA E SALAMANKËS DHE KUADRI PËR VEPRIM MBI EDUKIMIN SPECIAL (1994)**

Deklarata e Salamankës për arsimimin e të gjithë nxënësve me aftësi të kufizuara ra dakord në një konferencë mbarëbotërore të UNESCO-s të mbajtur në Salamanka në Qershor të vitit 1994 duke bërë thirrje për përfshirje. (UNESCO, 1994).

Domosdoshmëria dhe urgjenca e sigurimit të arsimit për të gjithë nxënësit, qofshin këta të fundit të rinj, apo të rritur brenda sistemit arsimor është e njohur. Është deklaruar se nxënësit me nevoja të veçanta arsimore duhet të pranohen në shkolla normale dhe shtohet se shkollat normale në



këtë orientim përfshirës janë mjetet më efektive për të luftuar qëndrimet diskriminuese duke krijuar në këtë mënyrë komunitete mikpritëse dhe duke ndërtuar një shoqëri gjithëpërfshirëse, për të arritur kështu arsimimin për të gjithë. (UNESCO, 1994, Seksioni 2)

***Parimi themelor i shkollave gjithëpërfshirëse, siç është propozuar në Deklaratën e Salamankës, është:***

*Të gjithë nxënësit duhet të mësojnë së bashku kur është e mundur dhe shkollat duhet të njohin dhe t’iu përgjigjen nevojave të ndryshme të nxënësve të tyre, duke pasur patjetër mbështetje për t’i përmbushur këto nevoja.*

Përveç kësaj, Konferenca e Salamankës miratoi një Kornizë të re për Veprim. Parimi i Kornizës për Veprim është se shkollat e zakonshme duhet të pranojnë të gjithë nxënësit pavarësisht nga zhvillimi fizik i tyre, kushtet intelektuale, sociale, emocionale, gjuhësore apo të tjera.

## 2. KËSHILLI I EVROPËS, DEKLARATA POLITIKE (2003) DHE PLANI I VEPRIMIT (2006)

Në konferencën e dytë evropiane të ministrave përgjegjës për politikën e integrimit për personat me aftësi të kufizuara në Malaga, Spanjë - të mbajtur në Maj të vitit 2003, ministrat kanë diskutuar parimet e përbashkëta që duhet të përshkojnë zhvillimin e politikave të nevojave specifike në të ardhmen dhe ofrimin e shërbimeve publike.

Ministrat konsideruan se “arsimi është një instrument themelor i integrimit social dhe se duhet të bëheshin përpjekje për t’iu dhënë mundësinë fëmijëve me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në një shkollë normale, nesë kjo e fundit është në interes të fëmijës për t’i lehtësuar atij kalimin nga shkolla në një arsim më të lartë, ose kalimin nga një arsim më i lartë në punë dhe për të zhvilluar konceptin e të mësuarit gjatë gjithë jetës”. (Këshilli Evropian, 2003)

Duke u bazuar në deklaratën e Malagas, Këshilli i Planit të Veprimit të Evropës për të promovuar të drejtat dhe pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri 2006-2015, përcakton objektivat dhe veprimet specifike për shtetet anëtare.

Ndër objektivat në planin e veprimit është sigurimi: se njerëzit me aftësi të kufizuara kanë mundësinë të pretendojnë për një vend në arsimin normal, duke nxitur kështu autoritetet përkatëse të njohin nevojat specifike të popullsisë së tyre.

Një veprim specifik për çdo shtet anëtar është sigurimi se çdo njeri me aftësi të kufizuara, duke përfshirë këtu edhe fëmijët, merr mbështetjen e kërkuar brenda sistemit të arsimit të përgjithshëm dhe mundësohet arsimimi i tyre në mënyrë efektive. Në rrethana të veçanta, kur në mënyrë profesionale është vlerësuar se nevojat e tyre nuk janë përmbushur në kuadër të edukimit në përgjithësi, shtetet anëtare do të sigurohen që masat mbështetëse efektive alternative janë dhënë në përputhje me qëllimin e përfshirjes së plotë. (Këshilli i Evropës, 2006)

### 3. KONVENTA NDËRKOMBËTARE E KOMBEVE TË BASHKUARA MBI TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA (2006)

Pas termit “edukim”, të Nenit 24 të Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (Dhjetor, 2006), fshihet një detyrim i fortë për qeveritë për të siguruar edukimin gjithëpërfshirës për të gjithë nxënësit. Kjo është theksuar në Nenin 24 për të drejtat e të gjithë personave me aftësi të kufizuara për arsimim, pa diskriminim dhe në bazë të mundësive të barabarta, shtetet duhet të sigurojnë një sistem arsimor gjithëpërfshirës në të gjitha nivelet dhe në të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Në realizimin e kësaj shtetet duhet të sigurojnë që:

- Personat me aftësi të kufizuar nuk përjashtohen nga arsimiti fillor që është i lirë dhe i detyrueshëm për të gjithë.
- Personat me aftësi të kufizuar marrin një arsimim fillor gjithëpërfshirës cilësor dhe falas duke pasur mundësi të barabarta në komunitetin ku ata jetojnë.
- Ofrohet akomodimi i arsyeshëm në bazë të kërkesave individuale.
- Personat me aftësi të kufizuar (nevoja specifike) marrin mbështetjen e duhur në kuadër të sistemit të arsimit të përgjithshëm për të mundësuar arsimimin e tyre efektiv.

- Masa mbrojtëse efektive të individualizuara në ambientet që rrisin zhvillimin akademik dhe social në përputhje me qëllimin e përfshirjes së plotë. (Kombet e Bashkuara, 2006)

#### 4. LIGJI SHQIPTAR PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR, NË LIDHJE ME GJITHËPËRFSHIRJEN

Ligji Nr. 69/2012.

#### KREU XI - ARSIMIMI I FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

##### **NENI 63**

##### **Parime të arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara**

- Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara synon zhvillimin e plotë të potencialit intelektual e fizik dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre për t'i përgatitur për integrim të plotë në shoqëri dhe në tregun e punës.
- Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore të specializuara për ta është përgjithësisht e përkohshme. Përfshirja dhe integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të arsimit bazë është parësore.
- Nxënësve, që nuk dëgjojnë e nuk flasin, u garantohet e drejta e komunikimit në gjuhën e shenjave, ndërsa atyre që nuk shikojnë, përdorimi i shkrimit Brail.

##### **NENI 64**

##### **Ndjekja e institucioneve arsimore nga fëmijët me aftësi të kufizuara**

- Nxënësve me aftësi të kufizuara u sigurohet arsimimi në shkollat e arsimit të mesëm të lartë, sipas kritereve të miratuara nga ministri dhe Ministri i Shëndetësisë.
- Nxënësi me aftësi të kufizuara qëndron në shkolla të specializuara deri në moshën 19 vjeç.

- Njësia arsimore vendore krijon një komision, të përbërë nga mjekë, psikologë, mësues dhe specialistë për fëmijët me aftësi të kufizuara, i cili, pasi shqyrton kërkesën e prindit ose të drejtorit të një institucioni arsimor, jep rekomandimet përkatëse për ndjekjen nga fëmija të një institucioni arsimor të zakonshëm a të specializuar.
- Prindërit vendosin nëse fëmija e tyre me aftësi të kufizuara do të ndjekë një institucion të specializuar ose të zakonshëm të arsimit bazë. Prindërit mund të largojnë në çdo kohë nga shkolla fëmijën, kur e gjykojnë se ai nuk përfiton nga mësimet ose ka mundësi të tjera më të mira.
- Ministria, në bashkëpunim me njësinë bazë të qeverisjes vendore dhe në këshillim me prindërit e komisionin, siguron arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në njërin nga dy llojet e institucioneve arsimore, të zakonshme ose të specializuara.
- Njësia arsimore vendore, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të Ministrit të Shëndetësisë, i siguron arsimim në shtëpi nxënësve që nuk mundën të ndjekin një shkollë të zakonshme ose të specializuar të arsimit bazë.

## **NENI 65**

### **Organizimi i arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara**

- Nxënësit me aftësi të kufizuara mësojnë sipas planit mësimor e programeve lëndore të zakonshme, të përshtatura për ta, ose sipas planit mësimor e programeve lëndore të specializuara për ta.
- Në institucionet arsimore të zakonshme, programi i personalizuar për nxënësin me aftësi të kufizuara hartohet nga një komision, në përbërje të të cilit janë mësues të fushave të ndryshme të të nxënësve të institucionit e psikologë. Hartimi i këtij programi bëhet në bashkëpunim me prindërit e nxënësve. Ndryshimi i programit të personalizuar brenda një institucioni arsimor vendoset nga komisioni brenda institucionit, në bashkëpunim me

prindërit e fëmijës.

- Nxënësve me aftësi të kufizuara u sigurohen mësues ndihmës dhe shërbim rehabilitues, sipas kritereve të përcaktuara me udhëzim të ministrit. Punonjësit arsimorë të institucioneve, që kanë nxënës me aftësi të kufizuara, certifikohen në programe trajnimi për trajtimin e këtyre nxënësve.
- Njësia përkatëse bazë e qeverisjes vendore u siguron nxënësve me aftësi të kufizuara mjediset e përshtatshme të mësimdhënies e të të nxënit, sipas standardeve të përcaktuara nga ministria.

## **GJITHËPËRFSHIRJA DHE RESPEKTIMI I DIVERSITETIT NË NIVEL SHKOLLE**

Qëllimi i gjithëpërfshirjes, nuk është të fshijë apo të injorohet diferencimet midis individëve. Në vend të kësaj, gjithëpërfshirja ka për qëllim t'u krijojë të gjithë nxënësve mundësinë që t'i përkasin një komuniteti shkollor dhe të edukohen brenda një kuadri në të cilin diferencimet mes individëve janë të njohura, por mbi të gjitha të pranuar.

### ***Shkolla si institucion parësor i gjithëpërfshirjes***

Qëllimi i gjithëpërfshirjes është të krijojë një kuadër brenda të cilit dallimet midis individëve janë të vendosura dhe të pranuar. Gjithëpërfshirja në edukim nuk duhet perceptuar si një proces ndihmës vetëm për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, por edhe për një mikpritje dhe pranim brenda shkollës i të gjithë nxënësve që kanë vështirësi në të nxënë, për shembull ata të cilin janë pjesë e komuniteteve të tjera, ata që jetojnë në zonat e deprivimit social ose ekonomik dhe ata që janë nga kultura të tjera dhe mund të mos flasin të njëjtën gjuhë.

Nuk duhet harruar se gjithëpërfshirja nuk kërkon fshehjen apo injorimin e dallimeve midis individëve: në thelb, gjithëpërfshirja nënkupton të drejtën për të marrë arsimimin e duhur.

Gjithë sa më lart do të jetë më e lehtë nëse:

- Njohim dhe pranojmë të drejtën e çdo fëmije për t'u arsimuar, në një institucion arsimimi, më pranë zonës ku banon.
- Përdorim parime të njëjta për vlerësimin e gjithë nxënësve apo kolegëve, janë të njëjta.
- Përpiqemi të jemi elastikë në mënyrën tonë të të menduarit e më pas të ndërtimit të punës, në rang klase, shkolle, apo komuniteti prindërisht, në përkatësi me nevojat që mund të shfaqin nxënësit, duke filluar që nga më të lehtëtat në vëzhgim e deri tek ato që kërkojnë më tepër vigjilencë e përgatitje profesionale.
- Konsiderojmë dallimet mes nxënësve si sfidë për rritje profesionale, më tepër se sa shkak për konsumim profesional.
- Perceptojmë shkollën si një institucion të edukimit dhe forcimit të vlerave, për të cilat ka aq nevojë shoqëria në të cilën po jetojmë, po aq sa edhe të arritjeve shkencore të nxënësit.
- Përpiqemi të pranojmë se gjithëpërfshirja në edukim, është vetëm një aspekt i gjithëpërfshirjes në shoqëri.

Në të njëjtën kohë, le të përpiqemi ta shohim gjithëpërfshirjen si një koncept shumë më të gjerë se integrimi. Në një shkollë në të cilën mendojmë se kemi integruar një fëmijë me aftësi të kufizuara, përshtatja me fëmijët e tjerë për një nxënës me aftësi të kufizuara, mund të jetë shumë më e vështirë se sa në një shkollë gjithëpërfshirëse. Nxënësi mund të jetë në të njëjtën klasë i ulur diku, por nëse nuk merr pjesë në mësim si gjithë të tjerët, me mundësitë që ka, atëherë kjo përpjekje nuk është aspak efiçente. Në të kundërt, në një klasë gjithëpërfshirëse të gjithë nxënësit me aftësi të kufizuara marrin pjesë në mësim dhe përmbushin potencialin e tyre, aq sa ata mund të japin.

Praktikat pozitive të gjithëpërfshirjes, tregojnë se regjistrimi i një numri të madh të nxënësve me aftësi të kufizuara në shkolla normale, i ka bërë këto shkolla që të marrin masa për të lehtësuar përfshirjen e këtyre nxënësve në aspekte të ndryshme të shkollës. Në këto shkolla drejtori, mësuesit dhe anëtarët e tjerë të stafit u janë përgjigjur nevojave të nxënësve duke thëlluar njohuritë e tyre dhe duke krijuar e zbatuar strategji të reja, në mënyrë që t'i kuptojnë dhe t'i

ndihmojnë në arsimimin që do t'iu ofrohet.

Pikërisht njohja e këtyre praktikave pozitive, i nderuar mësues, na nxit të mendojmë se hapi i parë i përballjes me një nxënës të ri me aftësi të kufizuara, i cili vjen për herë të parë në shkollën tonë, në klasën tonë, është përpjekja për të larguar panikun prej dështimit në punën me të dhe pranimi i tij në klasë, në të njëjtën mënyrë si nxënësit e tjerë, por me më tepër shtysë brenda vetes, për ta njohur atë, për ta ndihmuar duke thëlluar profesionalisht njohjen, për ta dashur e për t'ua shfaqur këtë vlerë njerëzore parreshtur, për të cilën ai ka në mënyrë të veçantë nevojë.

### **Përfitimet prej gjithëpërfshirjes**

#### ***Rritje e bashkëveprimit me bashkëmoshatarët***

Për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, ndjekja e arsimit publik, ofron rritjen e mundësive, për të përmirësuar aftësitë e komunikimit dhe bashkëveprimit me moshatarët e tyre. Kjo mund të çojë në zhvillimin e miqësive të reja në komunitetet e tyre lokale. Nxënësit me aftësi të kufizuara mund të përfitojnë nga përfshirja shoqërore përmes një ndjenje të reduktuar izolimi dhe duke iu nënshtruar etiketimit më pak negativ.

#### **ÇDOKUSH DUHET DHE MUND TË KETË MIQ**

- Sigurohu që të gjithë nxënësit të ndajnë kohën, hapësirën dhe aktivitetet!
- Edhe nëse nxënësit nuk flasin, ata kanë ende gjëra për të thënë!
- Krijto klasa në të cilat diversiteti pranohet jo thjesht tolerohet!
- Respekto hapësirat që nxënësit kërkojnë!
- Kërko interesat e nxënësve dhe mundohu t'i përfshish sa më shumë me bashkëmoshatarët e tyre! Familjet janë thelbësore, ju nuk mund ta bëni këtë vetëm!
- Kushtoj vëmendje për të kuptuar çfarë është dhe nuk është miqësia

#### ***Rritje e motivimit dhe zgjerim i interesave***

Ka një tendencë mjaft të favorshme, për nxënësit me nevoja të veçanta. Ata në klasat gjithëpërfshirëse mund të bëhen më të motivuar dhe mund të zgjerojnë interesat e tyre personale me njohuritë e botës, gjë që do i përgatisë ata për jetën e tyre si të rritur më vonë.

### ***Pranim dhe vlerësim i diferencave individuale***

Gjithëpërfshirja mund të ketë një ndikim të favorshëm mbi nxënësit me aftësi të kufizuara. Një mënyrë efektive, për t'i ndihmuar të gjithë nxënësit të tejkalojnë keqkuptimet që mund të kenë lidhur me njerëzit me nevoja të veçanta, është mbledhja e të gjithëve në klasa gjithëpërfshirëse. Në klasat gjithëpërfshirëse, të gjithë nxënësit mësojnë të pranojnë dhe vlerësojnë diferencat individuale.

### ***Krijimi i një shoqërie gjithëpërfshirëse***

Përvoja në klasa gjithëpërfshirëse i ndihmon të gjithë në komunitetin e shkollës të ndërtojnë një shoqëri gjithëpërfshirëse. Kur edukimi gjithëpërfshirës arrin të funksionojë në mënyrën e duhur mund të jetë i dobishëm edhe për nxënësit e tjerë të klasës. Për shembull, të gjithë nxënësit mund të përfitojnë nga të paturit dy mësues në klasë madje ata vetë mund të ndihmojnë fëmijët me aftësi të kufizuara. Nxënësit me arritje të ulta, të cilët nuk janë klasifikuar si nxënës me aftësi të kufizuara, përfitojnë nga këto strategji efektive të mësimdhënies.

Ka gjithashtu avantazhe për prindërit. Kur nxënësit me aftësi të kufizuara janë integruar në shkollat normale, prindërit e tyre kanë më shumë mundësi të marrin pjesë në shkollë dhe të ndjekin hap pas hapi zhvillimin që kanë fëmijët e tyre, duke i afruar kështu më afër me shkollën si institucion.

### **Planifikimi i gjithëpërfshirjes në nivel shkolle**

Edhe pse personi i kontaktit më të madh, gjatë gjithë kohës për nxënësit me aftësi të kufizuara, në mjedisin e shkollës, mund të perceptohet mësuesi, si burimi i ndikimit më të madh tek këta fëmijë, vëmendja duhet kushtuar ndaj gjithë procesit të zhvillimit të politikave dhe procedurave të shkollës, për nevoja të veçanta të edukimit e arsimimit. Rezultati është më efektiv kur procesi ndërmerret në bashkëpunim me partnerë të ndryshëm brenda komunitetit shkollor si mësuesit, prindërit dhe nxënësit si dhe agjencitë mbështetëse dhe shërbimet për komunitetin vendor.

Vështirësive me të cilat haset shkolla shqiptare sot, si numri i madh i nxënësve në klasa, zhvillimi i procesit mësimor me dy turne, problematika në infrastrukturën dhe projektimin e godinës së



shkollës shqiptare, për të përballuar kërkesat dhe nevojat e së tashmes së fëmijëve tanë, pashmangshmërisht i shtohet edhe kjo qasje e re: përfshirja e gjithë fëmijëve në shkollë, pavarësisht potencialit që mbartin.

Të mos harrojmë se kjo qasje e re, kërkon atë që ne pa frikë mund ta quajmë një shkollë gjithëpërfshirëse, e cila karakterizohet nga një proces i vazhdueshëm zhvillimi dhe vetëvlerësimi me qëllim eliminimin e pengesave për pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve.

Për këtë arsye, çdo individ i cili është pjesë e stafit të shkollës, duhet të mendojë me mendje të hapur të japë gjithë idetë dhe qëndrimet ee tij, gjatë gjithë kohës, në shqyrtimin dhe sipas rastit nëse është e domosdoshme dhe ndryshimit, të kulturës dhe etikës në të, vlerat, procedurat, stilin e menaxhimit, masat organizative, përmbajtjen e kurrikulës me qëllim krijimin e një klime më të përshtatshme për fëmijët më aftësi të kufizuara

në bazë të nevojave që ata kanë. Nga përdorimi i instrumentave të përdorur dhe analiza e të dhënave, në studimin e përshkruar më lart, rezulton se zhvillimi koherent i përfshirjes të të gjithë nxënësve në shkollat normale, përbën një sfidë për shkollën në vetvete.

Disa faktorë kontekstualë siç mund të jenë organizimi i klasës, koha, plan-programi, zona gjeografike në të cilën ndodhet shkolla, formimi bazë personal e profesional i mësuesit etj., mund të shkaktojnë vështirësi në mësimdhënie, megjithatë edhe pse ekzistojnë këto vështirësi, duke pasur një bashkëpunim të mirë dhe duke gjetur mënyrën për të menaxhuar situatën mund të arrihen rezultate të mira.

Për të arritur këtë ata duhet të menaxhojnë kohën, të kenë një përgatitje të mësimdhënies (plan-program individual), të mësojnë aplikimin e teknikave të reja të mësimdhënies për diferencimin dhe mësimin e individualizuar, të ruajnë një ritëm të përshtatshëm për të mbuluar presionet dhe pritshmëritë që lindin në përgatitjen e nxënësve dhe vigjilencën për të vërejtur çdo detaj të suksesit të tyre në çdo fushë të zhvillimit.

Mësuesit, zakonisht, duhet të kenë mbështetje dhe duhet të bashkëpunojnë me specialistë dhe me mësues ndihmës. Por në të njëjtën kohë duhet të jemi të përgatitur se procesi i zhvillimit të politikave dhe ndryshimi që është i nevojshëm për përfshirjen efektive të nxënësve me aftësi të

kufizuara në shkolla normale, është kompleks dhe kërkon kohë e mbi gjithçka tjetër, thyerjen e disa pengesave dhjetërvjeçare të perceptimit të një dukurie të tillë prej masës më të madhe të popullit tonë.

***Për këtë arsye, do të ishte ndoshta me e thjeshtë, nëse do të marrim në konsideratë se:***

- Politikat shkollore dhe procedurat në lidhje me vendosjen e marrëveshjeve për mësimdhënie për nxënësit me aftësi të kufizuara mund të vendosen në konsultim me anëtarët e tjerë të stafit mësimdhënës.
- Ekipi drejtues i shkollës, apo një grup specifik i ngritur, i përbërë nga mësues të cilët kanë marrë më tepër trajnime në lidhje me procesin e gjithëpërfshirjes, të përpiqen të njohin së pari nivelin e njohurive të stafit të shkollës, për procesin e gjithëpërfshirjes, duke hartuar apo përshatur pyetësorë për ta. Njohja e këtij niveli do të ndihmonte në përmirësimin dhe lehtësimin e hartimit të politikës shkollore, për të arritur më tej tek rezultati i pritshëm nga shkolla.
- Pjesëmarrja në një mënyrë kuptimplotë të nxënësve me nevoja të veçanta në aktivitetet e rregullta të klasës në nivelin më të madh të mundshëm.
- Vendimet gjithmonë duhet të merren në bashkëpunim me prindërit. Duke marrë në konsideratë faktin se vendbanimi i prindërve, sfondi kulturor, sfondi arsimor i prindërve të një shkolle, pritshmëritë e tyre për arritjet dhe edukimin e fëmijëve, mund të jenë shumë të ndryshme dhe nga ana tjetër faktin se procesi i gjithëpërfshirjes përbën një proces relativisht të ri në dinamikën e madhe të zhvillimeve arsimore në Shqipëri, do të ishte shumë e nevojshme për çdo shkollë të njihje edhe nivelin e njohurive të prindërve në lidhje me procesin e gjithëpërfshirjes në përgjithësi dhe në edukim në veçanti. Për këtë duhet të përdoren pyetësorë apo intervista si edhe fokus-grupe, me qëllim orientimin drejt hartimit të politikës së shkollës dhe njëkohësisht lehtësimit drejt ndërtimit të një filozofie gjithëpërfshirëse në shkollë dhe përtej saj.

Nga njohja e nivelit të njohurive të mësuesve rreth gjithëpërfshirjes, mund të hartohet një hartë nevojash të mësuesve, e cila t'u prezantohet DAR-eve apo ZA-ve për të marrë trajnimet e nevojshme për të patur kështu mundësinë të kujdesen në mënyrë maksimale për fëmijët me aftësi të kufizuara që kanë në klasat e tyre. E përveç tyre, ata mund të ndërtojnë seanca

kualifikimi të brendshëm, mes mësuesve të cilët kanë pasur raste specifike në klasat e tyre dhe mësuesve të cilët pranojnë të ndajnë përvojat pozitive dhe sfidat me të cilat janë përballur në stafin e përbashkët të mësuesve.

### **Hartimi i politikave shkollore gjithëpërfshirëse**

Plani shkollor duhet të përcaktojë qëllimet dhe objektivat e shkollës për të gjithë nxënësit dhe duhet të jetë i lidhur me misionin e shkollës. Pikërisht gjatë këtij procesi, do të ishte shumë e domosdoshme vendosja e disa përparësive, të cilat do të udhëhiqnin më pas veprimtaritë praktike në rang shkolle dhe klase. Këto përparësi mund të përcaktohen bazuar fillimisht mbi vlerësimin e situatës nga të dhënat e pyetësorëve nga mësuesit apo prindërit, të përmendura më lart. Kjo do të thotë pikërisht se përparësitë mund të jenë të ndryshme në shkolla të ndryshme në varësi të nevojave dhe perceptimit të stafit të mësuesve.

#### ***Të gjitha shkollat mund të kenë parasysh aspekte të tilla përparësish, si:***

##### *Krijimi i kulturave gjithëpërfshirëse përmes:*

- ndërgjegjësimin të komunitetit të shkollës dhe rreth shkollës rreth procesit të gjithëpërfshirjes;
- promovimi i vlerave të gjithëpërfshirjes.

##### *Hartimi i kulturës gjithëpërfshirëse përmes:*

- organizimit të një shkolle për të gjithë;
- nxitjes së mbështetjes për të ndryshmen.

##### *Zbatim i praktikave gjithëpërfshirëse përmes:*

- mësimdhënies së planifikuar duke pasur gjithë nxënësit në mendje;
- përdorimit të dallimeve mes nxënësve si burim për mësimdhënie dhe nxënie.

Indeksi për gjithëpërfshirjen propozon përcaktimin e treguesve si më poshtë në lidhje me

përparësitë e përmendura më lart<sup>1</sup> :

## **Aspekti A**

### **Krijimi i kulturave gjithëpërfshirëse**

#### **A.1. Ndërtimi i komuniteteve**

- Çdokush ndjehet i mirëseardhur.
- Nxënësit ndihmojnë njëri-tjetrin.
- Stafi bashkëpunon me njëri-tjetrin.
- Stafi dhe nxënësit trajtojnë njëri-tjetrin me respekt.
- Ekziston një marrëdhënie bashkëpunimi mes stafit dhe prindërve/kujdestarëve.
- Gjithë komunitetet vendore përfshihen në shkollë.

#### **A.2. Promovimi i vlerave të gjithëpërfshirjes**

- Ekzistojnë pritshmëri të larta për çdo nxënës.
- Stafi, drejtuesit, nxënësit dhe prindërit/kujdestarët përqafojnë një filozofi për gjithëpërfshirjen.
- Nxënësit vlerësohen të gjithë në mënyrë të barabartë.
- Stafi dhe nxënësit trajtojnë njëri-tjetrin si qenie humane, po aq sa edhe si zotërues të rolit përkatës.
- Stafi përpiqet të eliminojë pengesat në të nxënë dhe pjesëmarrje në gjithë aspektet e shkollës.
- Shkolla përpiqet të minimizojë të gjitha format e diskriminimit.

## **Aspekti B**

### **Hartimi i kulturave gjithëpërfshirëse**

#### **B.1. Organizimi i një shkolle për të gjithë**

- Takimet e stafit janë të përcaktuara dhe transparente.

<sup>1</sup> Booth, T. and Ainscoë, M. (2002, CSIE). Index for Inclusion: Developing learning and participation in schools.

- Stafi i ri ndihmohet të përshtatet me shkollën.
- Shkolla pranon gjithë nxënësit që janë pjesë e zonës shkollore ku ajo ndodhet.
- Shkolla kujdeset që godina e saj të jetë funksionale fizikisht për të gjithë njerëzit.
- Të gjithë nxënësit e rinj ndihmohen të përshtaten në shkollë.

## **B.2. Nxitje e mbështetjes për të ndryshmen**

- Të gjitha format e mbështetjes janë të koordinuara. Veprimtaritë që zhvillojnë mësuesit, i përgjigjen ndryshueshmërisë së nxënësve.
- Politikat e nevojave specifike në të nxënë, janë politika gjithëpërfshirjeje.
- Për të reduktuar pengesat në të nxënë dhe pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve përdoret kodi i praktikës për nevojat specifike në të nxënë.
- Politikat e mbështetjes sjellore, janë pjesë e zhvillimit të kurrikulës dhe politikave të mbështetjes në të nxënë.
- Bëhen përpjekje që presionet për përjashtime disiplinore të jenë sa më të pakta.
- Bëhen përpjekje që barrierat për frekuentimin e shkollës të reduktohen.
- Bëhen përpjekje që ngacmimet verbale ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara të minimizohen.

## **Aspekti C**

### **Zbatimi i praktikave gjithëpërfshirëse**

#### **C.1. “Orkestrimi” i të nxënit**

- Mësimdhënia planifikohet duke pasur në mendje tipet e të nxënit të të gjithë nxënësve që u jepet mësim.
- Mësimi nxit pjesëmarrjen e gjithë nxënësve.
- Mësimi zhvillon të kuptuarin e ndryshimit mes nxënësve.
- Nxënësit janë aktivisht të përfshirë në procesin e të nxënit sipas mënyrës së tyre specifike.
- Nxënësit mësojnë duke bashkëpunuar.
- Vlerësimi ndihmon tek arritjet gjithë nxënësve.
- Disiplina në klasë bazohet tek respekti reciprok.

- Mësuesi planifikon, jep mësim dhe rivlerëson në partneritet me nxënësit e prindërit.
- Ndihmësit në mësimdhënie, mbështesin procesin e të nxënësve dhe pjesëmarrjen e gjithë nxënësve në klasë.
- Detyrat e shtëpisë kontribuojnë tek të nxënësve për të gjithë.
- Të gjithë nxënësit marrin pjesë në aktivitetet jashtë klasës.

## **C.2. Nxitja e burimeve**

- Ndryshimet mes nxënësve përdoren si burime për mësimdhënien dhe nxënien.
- Përvoja e stafit të mësuesve ndahet me të gjithë në formë kualifikimi praktik.
- Stafi i mësuesve është vazhdimisht në kërkim të burimeve për të mbështetur të nxënësve dhe pjesëmarrjen e nxënësve.
- Burimet në komunitet janë të njohura për mësuesit.
- Burimet e shkollës janë transparente dhe të organizuara në mënyrë që të mbështesin përfshirjen.

E rëndësishme është që në kushtet e pranimit në shkollë të të gjithë nxënësve, pavarësisht potencialeve që zotërojnë dhe mundësive të arritjeve, gjatë hartimit të planit shkollor, duhet të përpiqemi, që këtë të fundit, as drejtuesit dhe as stafi i shkollës, të mos e konsiderojnë si një dokument formal, i cili mund të udhëheqë mësuesit dhe drejtuesit drejt punës së tyre, mbështetur në korniza të aplikuara edhe në vitet e mëparshme, të lehta për t'u ndjekur (16% prej mësuesve të intervistuar shprehin këtë qëndrim gjatë studimit). Por të përpiqemi që gjatë hartimit të tij, të përfshijmë disa procedura të cilat të përmbajnë referenca për përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara (për shembull, çastin e regjistrimit, disiplinën, mos-etiketimin nga fëmijët e tjerë, shëndetin, sigurinë, mbështetjen) dhe të tjera të cilat kanë të bëjnë me nevojat specifike (për shembull, rolin e mësuesit ndihmës, planin individual, gatishmërinë për ndihmë nga ana e prindit, etj.)

### **Politika e regjistrimit në shkolla**

Ka dëshmi se disa shkolla vazhdojnë të kenë ende politika kufizuese kur vjen puna te regjistrimi, që çojnë në përjashtimin e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe ata që kanë probleme me të nxënësve.

Disa prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara kanë përjetuar vështirësi në lidhje me regjistrimin e fëmijëve të tyre në shkollën e zgjedhur (28 prindër të intervistuar kanë shprehur këtë qëndrim gjatë studimit), të cilat nuk kanë pasur të bëjnë drejtpërdrejt me procedurën teknike të regjistrimit, por me qëndrimin e fshehur, frikën, pasigurinë, jo të shfaqur haptazi të mësueve, apo drejtuesve, në lidhje me këta fëmijë. Për këto arsye:

Hapi i parë i ndërmarrë në nivel shkolle, për të gjithë fëmijët që ofrohen të arsimohen në të, është pranimi prej punonjësve të saj se: “Çdo fëmijë është një individ”.

Rrjedhimisht, një nga detyrat parësore gjatë hartimit të planit të një shkolle, është edhe marrja e masave të arsyeshme për strehimin e nxënësve me aftësi të kufizuara. Madje, duhet marrë në konsideratë edhe fakti tjetër se ekzistojnë praktika të përzgjedhjes së disa nxënësve dhe refuzimi i disa të tjerë në mënyrë që të krijohet një bashkësi e caktuar nxënësish (për shembull, ata që janë më të aftë në arritje shkollore), në shkolla të veçanta, apo madje edhe në klasa të veçanta brenda të njëjtës shkolle, ç’ka është totalisht e papranueshme, ndaj, praktika të tilla duhet të ndërpriten.

Hapi i dytë që duhet ndërmarrë në nivel shkolle për mirëpritjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në të, është kërkimi i informacionit paraprak nga prindërit e këtyre fëmijëve.

Është praktikë e mirë për një shkollë, që të kërkojë të gjitha informacionet e mundshme rreth një fëmije me aftësi të kufizuara para regjistrimit të tyre. Madje, diçka e tillë, mund të bëhet pjesë e procesit të pranimi në shkollë. Në këtë drejtim prindërve mund t’u kërkohet që të sjellin raporte nga specialistë të fushës, p.sh. psikologë, terapistë të folurit dhe gjuhës ose profesionistë të tjerë. Ky informacion nuk duhet normalisht të përdoret në asnjë mënyrë për të vendosur nëse fëmija duhet ose jo të regjistrohet në shkollë. Ky informacion duhet të përdoret nga shkolla për të njohur më mirë gjendjen e fëmijës dhe për të siguruar burime që do e ndihmojë për kryer me të një mësimdhënie sa më efektive e mbi të gjitha për të vendosur me të, një marrëdhënie, në të cilën fëmija mund të ndjejë mbështetjen dhe sigurinë, si në aspektin fizik, por mbi gjithçka tjetër në atë emocional.

### **Frekuentimi dhe pjesëmarrja**

Më gjithë ngarkesat e njohura në një fillim viti shkolle, do të ishte tepër eficient krijimi i një procesi lehtësimi dhe monitorimi nga afër të fëmijëve me aftësi të kufizuara, sidomos gjatë ditëve të para,

muajve të parë apo vitit të tyre të parë në shkollë. Por duke pasur parasysh se qëllimi parësor, i kujdesit ndaj nxënësve me aftësi të kufizuara, është nxitja e tyre për të mësuar në mes të nxënësve të tjerë, gjatë hartimit të politikave të brendshme, apo planit të punës, duhet të përfshihen edhe strategjitë për lehtësimin e procesit të edukimit, për këta nxënës me nevoja të veçanta. P.sh. vijimi i dobët në periudhën e parë kohore menjëherë pas fillimit të shkollës, mund të jetë tregues se një nxënës mund të ketë vështirësi për t'u përshtatur me shkollën. Për këta nxënës të cilët kanë vështirësi në përshtatje, mund të merren masa, të cilat mund të synojnë tek rishikimi i kohës fizike të mundshme që fëmija mund të kalojë në shkollë, e cila mund të rritet gradualisht apo mjediset të cilat mund të jenë më efektive për të, për të mos kaluar më pas në pasoja më serioze siç mund të jenë braktisja e shkollës herët. Të gjitha këto, mund të monitorohen nga drejtori i shkollës ose nga një anëtar i stafit të mësimdhënies, si edhe të jenë në përputhshmëri të plotë me Dispozitat Normative dhe udhëzimet e dërguara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

### **Kodi i sjelljes dhe disiplinës, si dhe masat për të parandaluar ngacmimin e nxënësve me aftësi të kufizuara**

Nxënësit me aftësi të kufizuara, mund të bien shumë lehtë pre e ngacmimeve fizike, psikologjike apo emocionale. Nëse këta nxënës i nënshtrohen trajtimit të padrejtë brenda shkollës nga anëtarët e stafit ose nga nxënësit e tjerë, efektet fizike, psikologjike dhe emocionale mund të jenë shumë të dëmshme për ta, duke prodhuar jo rezultatin e dëshiruar për ne në arritjen e synimit fillestar për nxënësit me aftësi të kufizuara, por përkundrazi në dështim të institucionit "shkollë" si rezultat i mosinteresimit për të marrë masa të arsyeshme për të parandaluar ngacmimin.

Të gjithë anëtarët e stafit mësimor, vazhdimisht mund t'u referohen nxënësve duke përdorur gjuhën e parë të personit, të komunikojnë me ta dhe me familjet e tyre në një mënyrë respektive dhe konfidenciale për të gjithë nxënësit, duke përfshirë këtu edhe nxënësit me aftësi të kufizuara të rënda.

Kjo praktikë sugjerohet të përfshijë përdorimin e atij komunikimi, i cili thekson pikat e forta të çdo individi në vend të përqëndrimit në aspektet negative që ai person mund të ketë, duke rekomanduar njëkohësisht se me këta persona duhet të përdoret një gjuhë tjetër p.sh.: mund të shprehemi "Ajo përdor një karrocë." në vend që të shprehemi "Ajo është e lidhur në një karrige me rrota". Shembuj të tjerë përfshijnë emërtimin e këtyre fëmijëve si persona me nevoja specifike



në vend të emërtimit të tyre si persona me të meta. Edhe pse në pamje të parë, mund të konsiderohen si detaje, janë ato të cilat mund të bëjnë ndryshimin që aq shumë e dëshirojmë, duke u aplikuar në shkolla. Kur i gjithë personeli të jetë sensibilizuar për të përdorur këtë lloj gjuhe në vend të asaj çka ne dëgjojmë rëndom, gjithçka do të bëhet më e thjeshtë për këta fëmijë.

Praktika e këndvështrimit të njerëzve për atë që janë dhe jo për çka kanë, pranon se individët me aftësi të kufizuara, janë pikë së pari NJERËZ. Duke njohur vlerat e çdo njeriu, duke respektuar dinjitetin e tij, individualitetin dhe aftësinë që ata kanë, ne mund të përfshijmë në jetën shoqërore çdo individ, pavarësisht aftësisë apo paaftësisë që ai ka. Është shumë e rëndësishme të marrim në konsideratë se fjalët që ne përdorim kanë më shumë fuqi nga sa ne mendojmë. Fjalët që ne përdorim mund të ngrejë ose ulin pritshmëritë tona, të dëmtojnë ose të ndihmojnë, të vrasin shpresa apo të ndërtojnë ëndrra dhe shumë më tepër. Duke përdorur një gjuhë që komunikon respekt për të gjithë njerëzit pa përjashtim, ne do të fillojmë të ndikojmë edhe tek individët e tjerë dhe më tej në shoqërinë ku jetojmë.

Për këtë arsye, promovimi i një etike të shkollës, apo rishikimi i saj nëse ekziston tashmë, i vlerave dhe klimës që ve në dukje respektin, tolerancën dhe pranimin e diversitetit duhet të jetë në qendër të zhvillimit të politikave dhe praktikave përfshirëse në shkollë. Çdo anëtar i komunitetit të shkollës ka të drejtë të marrë pjesë si fizikisht ashtu edhe psikologjikisht për të krijuar një ambient të sigurt dhe një atmosferë të lirë nga diskriminimi, paragjykimi dhe ngacmimi. Për këtë arsye i nderuar mësues, drejtues, staf i shkollës, prind, qytetar, je i lutur, të shprehësh reflektimin tënd personal, duke dhënë sugjerime e duke ndihmuar në krijimin e kësaj klime mirëpritëse, jo fyese, por pranuese, në atë mjedis që e quajmë shkollë.

Për këtë arsye, do të shërbente hartimi i një kodi të sjelljes dhe disiplinës dhe masa që duhet të merren kundër ngacmimit, nga vetë shkolla, madje gjatë këtij procesi të kërkohet ndihmë edhe nga kërkime të dobishme që mund të burojnë prej universiteteve, duke menduar se këto udhëzime do të ndihmojnë dhe lehtësojnë pjesëmarrjen në edukim të të gjithë nxënësve.



1	2	3	4	5	6	7	8	9	10					
Asnjëherë	Rrallë herë		Ndonjëherë		Shpesh		Pjesën më të madhe të kohës			Gjithmonë				
6. Shkolla merr masa për trajnimin e stafit për problemet e gjithëpërfshirjes dhe respektimit të diversitetit														
7. Shkolla ka procedurë për identifikimin dhe analizën e shkaqeve për përsëritjen e vitit shkollor dhe ndërmerri masa me kohë për zvogëlimin e numrit të nxënësve që përsërisin klasë														
8. Mësuesit dhe nxënësit identifikojnë nxënësit e rrezikuar për largim nga mësimi dhe shkolla për shkak të ndikimit të faktorëve të ndryshëm														
9. Shkolla informon nxënësit për mundësitë e shkollimit të mëtejshëm, edukimin në karrierë etj														

### Standardi 3: Përshtatja me nevojat e zhvillimit të fëmijës

Treguesi	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1. Mjedisi i shkollës dhe hapësirat fizike u shërbejnë fëmijëve të grupmoshave të ndryshme										
2. Veprimtaritë organizohen në mënyrë që ti përshtaten fazave të zhvillimit të fëmijëve										

### Standardi 4: Mjedisi pa pengesa

Treguesi	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1. Shkolla siguron që mjetet mësimore janë të arritshme dhe të përdorshme nga të gjithë, pavarësisht moshës, gjinisë dhe nevojave të veçanta										
2. Mjedisi nxit integrimin e të gjithë nxënësve pavarësisht nga grupi të cilit i përketin (gjinia, aftësi e kufizuar, etnia, feja etj) në të njëjtin mjedis të nxëni dhe mësimdhënieje										
3. Gjatë planifikimit të mjedisit të shkollës janë bërë përshtatje të veçanta në mjedis për nxënësit me nevoja të veçanta										
4. Të gjithë nxënësit, stafi dhe vizitorët kanë mundësi të përdorin mjetet sanitare										
5. Mësuesit e përshtasin mjedisin e punës dhe aktivitetet e të mësuarit, në mënyrë që fëmijët me përkatësi të ndryshme kulturore, me nevoja të ndryshme shoqërore të jenë pjesëmarrës të barabartë										

### Standardi 5: Infrastruktura e disponueshme për personat me aftësi të kufizuar

Treguesi	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1. Të gjitha rrugët e kalimit dhe dyert kanë një minimum prej 90cm gjerësi që të mundësojnë kalimin e një karroce të personit me aftësi të kufizuar fizike										
2. Sipërfaqet e dyshemesë janë të forta, të qëndrueshme, të rezistueshme ndaj rrëshqitjes dhe të sheshta										
3. Në shkollë ka rampa për personat me aftësi të kufizuara										
4. Shkolla zotëron të paktën një karrige personi me aftësi të kufizuar										
5. Shkolla ka tualete të përdorshme për personat me aftësi të kufizuara. Përdoruesit e karrigeve me rrota kanë mundësi										

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10						
Asnjëherë	Rrallë herë		Ndonjëherë		Shpesh		Pjesën më të madhe të kohës			Gjithmonë					
të afrohen, të hyjnë, të lëvizin dhe të përdorin mjetet sanitare brenda ambienteve të shkollës															
6. Klasat kanë hapësirë të mjaftueshme për të lejuar lëvizjen e nxënësve me aftësi të kufizuar															

### Standardi 6: Infrastruktura duhet të jetë e disponueshme nga të dy gjinitë

Treguesi	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1. Në shkollë ka tualete të veçanta për vajzat dhe për djemtë										
2. Sigurimi i sheshit të lojërave krijon mundësi që si djemtë ashtu edhe vajzat të mund të marrin pjesë lirisht në sporte dhe lojëra										

### Standardi 7: Qeverisja e shkollës

Treguesi	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1. Programi shkollor paraqet strategji për të mundësuar pjesëmarrjen si të djemve ashtu edhe të vajzave në Qeverinë e Nxënësve gjithashtu dhe të burrave dhe të grave në Bordet e shkollave										
2. Programi shkollor siguron strategji për të mundësuar pjesëmarrjen e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe të pakicave etnike në Qeverinë e Nxënësve										

### Standardi 8: Veprimtaritë mësimore

Treguesi	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1. Gjatë zbatimit të programit shkollor përdoren praktika, modele, veprimtari që sigurojnë përzierjen e grupeve pa dallim të origjinës, identitetit kulturor, gjuhës, aftësive apo rrethanave ekonomike										
2. Programi shkollor përmban njohuri dhe aftësi për të identifikuar dhe eliminuar paragjykimet në shkollë										
3. Programi shkollor mundëson që nxënësit të shprehin pikëpamjet e tyre mbi politikat e shkollës për gjithëpërfshirjen dhe respektimin e diversitetit										
4. Kurrikula ofron përmbajtje dhe modele të respektimit të kulturave, traditave, besimeve, gjuhëve të ndryshme etj										
5. Mësuesit u ofrojnë nxënësve materiale didaktike që pasqyrojnë në mënyrë të drejtë diversitetet kulturore dhe rëndësinë e diversiteteve në shoqëri										